

ALBANA MUCEKU, ANDROMAQI HALOÇI

**KONCEPTI “NDËRGJUHA” DHE ANALIZIMI I GABIMEVE GJATË
PËRVETËSIMIT TË GJUHËS ITALIANE SI GJUHË E DYTË E HUAJ
NË SHKOLLAT E MESME**

Abstrakt

Ndryshimet që ka pësuar shoqëria gjatë viteve të fundit janë të lidhura ngushtë me fenomenin e globalizmit i cili ka pasur ndikim mjaft të rëndësishëm në jetët e njerëzve duke ndryshuar jo vetëm mënyrën e bashkëjetesës por edhe të përshtatjes së mentaliteteve dhe mënyrës së komunikimit ndërmjet tyre. Në këto kushte edhe komunikimi gjuhësor pësoi një ndryshim të madh përse i përket rëndësisë që merr përvetësimi i një gjuhe të huaj në përputhje me nevojat jetësore. Përhapja e gjuhës angleze e rendit këtë gjuhë si gjuhën e dytë pas gjuhës amtare. Ky proces shoqërohet me një sërë ndryshimesh të tjera të cilat kushtëzojnë përvetësimin e gjuhëve të tjera të huaja të cilat konsiderohen si gjuhë të huaja të dyta. Qëllimi i këtij punimi është të shpjegojë konceptin “Ndërgjuhë” nën një këndvështrim të ri për kontekstin shqiptar dhe për kushtet në të cilat gjuha italiane studiohet si gjuhë e huaj e dytë si edhe të analizojë gabimet e bëra nga nxënësit gjatë përvetësimit të kësaj gjuhe. Ky është problemi kryesor që do të trajtohet në këtë punim i bazuar dhe vlerësuar në këto aspekte:

1. Në trajtimin teorik të konceptit “Ndërgjuhë” i parë në një përjasje të ngushtë me realitetin shqiptar në të cilin studiohet gjuha italiane.
2. Në grumbullimin dhe analizimin e të dhënave të para dhe vlerësuara në aspektin praktik.

Në përfundim të këtij punimi do të arrihet në konkluzionin se në një realitet të tillë gjatë procesit të përvetësimit të gjuhës italiane si gjuhë e huaj e dytë ndikimet gjuhësore vijnë jo vetëm nga gjuha shqipe dhe angleze por edhe nga gjuhët e tjera të huaja me të cilat janë në kontakt nxënësit shqiptarë.

Fjalët kyçe: Ndërgjuha, gjuhë e huaj e dytë, sistem gjuhësor, komunikim, krahasim ndërgjuhësor dhe ndërkulturor.

Trajtimi teorik i konceptit “Ndërgjuhë”

Termi në fjalë lidhet ngushtë me procesin e përvetësimit të një gjuhe të huaj. Ndërgjuha është një sistem gjuhësor që vihet re gjatë procesit të përvetësimit të një gjuhe të huaj i cili është në ndryshim të vazhdueshëm. Ky sistem gjuhësor nuk është gjë tjetër veçse një produkt gjuhësor i shprehur nga folësi i cili në fazat e para të procesit të përvetësimit të gjuhës së huaj bazohet kryesisht në modelin e gjuhë së tij të parë.

Ky sistem ose gjendje “e gjuhës” çon në krijimin e strukturave pothuajse identike me ato të gjuhës nënë të cilat me kalimin e kohës dhe sa më shumë folësi përvetëson dhe përmirëson performancën e tij gjuhësore aq më pak ngjason me ato të gjuhës së parë. Këtë fazë mund ta quajmë edhe faza e interferencave gjuhësore e cila zvogëlohet, por asnjëherë nuk zhduket. Pra hapësira ndërmjet dy apo më shumë sistemeve gjuhësore të një individi nuk zhduket, gjithmonë do të ketë vend për ndikime në këtë hapësirë (Mezzadri M. 2002¹). Këtu bëjnë përjashtim individët biling. Për të kuptuar më mirë termin ndërgjuhë duhet ta analizojmë atë në aspektin historik. Në fund të viteve '50 dhe në fillim të viteve '60 procesi i përvetësimit të gjuhëve të huaja sipas Komportamentizmit (Bihevizmi) shihej ngushtësisht i lidhur me përvetësimin e sjelljeve të reja. Gjuha tashmë e quajtur “produkt” konsiderohej si një element të cilin individi e përdor në mjedise të ndryshme për nevojat e tij. Është plotësisht e natyrshme që individi gjatë përdorimit të gjuhës të manifestojë gabime të cilat vijnë si pasojë e ndikimit dhe ndërhyrjes së sjelljeve ekzistuese dhe gjuhës së parë që ai zotëron.

Ky këndvështrim i ri kundërshtohet fillimisht nga Stephan Pit Corder i cili në analizën e tij bazohet në teorinë e Chomskit (Liu M. & Liu X. Sh. 1998²). “Individi lind i pajisur me një mekanizëm të brendshëm i cili i lejon të përvetësojë gjuhë dhe të ndërtojë një sistem gjuhësor të caktuar”.

Më vonë termi “Ndërgjuhë” u trajtua më gjerësisht nga Selinker i cili hodhi bazat e një teorie psikolinguistike të re. Ai përdor këtë term për të përcaktuar sistemin gjuhësor që folësi e zhvillon gjatë procesit të përvetësimit të gjuhës target. Sipas tij kur një folës jo nativ kërkon të shprehet apo të përdorë gjuhën e huaj në një situatë dhe mjedis të caktuar fjalitë dhe strukturat që ai ndërton nuk rezultojnë të ngjashme me ato që në një rast të ngjashëm do të përdorte një folës nativ. Kjo shpjegon faktin se në këtë rast pavarësisht se kemi të bëjmë me të njëjtën gjuhë sistemet gjuhësore që prodhohen nga folësit janë të ndryshme. Pikërisht këtë rast Selinker e quan “Ndërgjuhë”.

Sipas tij gjatë përvetësimit të një gjuhe të huaj individi nuk fillon nga zero por as edhe plotësisht nga kodi i gjuhës nënë. Pika e nisjes për një individ që sapo ka filluar të mësojë apo të përvetësojë një gjuhë të huaj mund të jetë një regjistër i thjeshtë i gjuhës së tij të parë një sistem gjuhësor bazik, një sistem semantiko-sintaksor i cili vjen natyrshëm si produkt i proceseve njohëse (i pa bazuar në asnjë strukturë apo rregull gramatikor) dhe nga i cili lind dhe zhvillohet çdo gjuhë.

¹ M. Mezzadri (2002), *La correzione degli errori Articolo apparso su In.it*, anno 3 N.12, pp.4-9. www.italianoperstranieri.it.

² M. Liu, X. Sh. Liu (1998), *Chomsky and Knowledge of Language*, Proceedings of the Twentieth World Congress of Philosophy Boston, 10-15 August 1998, Massachusetts U.S.A. <https://www.bu.edu/wcp>.

Koncepti “Ndërgjuhë” nuk mund të interpretohet dhe analizohet pa vëzhgimin dhe analizimin e gabimeve të cilat në faza të ndryshme të procesit të përvetësimit të një gjuhe të huaj janë të natyrave dhe niveleve të ndryshme. Sa më shumë zvogëlohet distanca ndërmjet dy sistemeve gjuhësore aq më shumë ulet dhe ndryshon natyra e gabimeve të bëra nga individit.

Proceset prej të cilave krijohet “Ndërgjuha” dhe mekanizmat që e karakterizojnë janë një fushë studimi e re. Disa gjuhëtarë e shikojnë më të favorshëm konceptin “Ndërgjuhë” për përcaktimin e fazës që karakterizon kalimin nga gjuha e parë në atë “target” sesa termin “gabime” sepse i gjithë produkti i individit nuk duhet të shihet si një bashkësi fjalësh dhe fjalish të mbushura me gabime por si një sistem që udhëhiqet nga rregulla të paramenduara i cili është gjithmonë në zhvillim (Pallotti G., 1998³).

Natyra dhe Klasifikimi i Gabimeve

Sipas Pit Corder gabimet mund të jenë:

“Gabime transferimi”: në këtë rast gabimet vijnë si rezultat i ndikimeve të jashtme gjuhësore nga gjuha nënë apo nga gjuhë të huaja të tjera të mësuara më parë. (Elementi transfer)

“Gabime analogjike”: në këtë rast këto gabime vijnë si rezultat i ndikimeve të brendshme dhe lidhen me mosnjohjen e rregullave të gjuhës.

“Gabime të shkaktuara gjatë mësimi”: në këtë rast këto gabime vijnë si rezultat i metodologjisë së mësuesit dhe kushteve në të cilat mësohet (Sula A., 2009⁴).

Duke ju referuar nivelit të përvetësimit të gjuhës si edhe vlerësimit të nivelit të gabimeve mund të themi se “Ndërgjuha” kalon nëpër tri faza kryesore:

- Faza fillestare: Në këtë fazë numri i fjalëve në përdorim është i vogël, kryesisht përdoren fjalët kyçe, ka përdorim të shumtë dhe të shpeshtë të shenjave, gjesteve dhe gjuhës së trupit. Forma morfologjike e thënieve është rastësore dhe me gabime. Forma sintaksore është shumë e ulët.

- Faza e mesme (bazike): Në këtë fazë vihet re një përmirësim dhe zhvillim i aspektit morfologjik të thënieve. Konceptet kryesore gramatikore si numri, gjinia koha e foljeve, shprehen nëpërmjet trajtave të tyre gramatikore.

- Faza përmbyllëse: Në këtë fazë produkti gjuhësor i folësit tenton gjithmonë e më shumë t’i afrohet atij të folësit nativ. Forma morfologjike është e rregullt dhe ndërtimi i strukturave foljore është e mirëpërcaktuar. Gjithmonë e më shumë shihen përmirësime dhe zhvillime të performancës gjuhësore të folësit apo përdoruesit të gjuhës.

³ G. Pallotti (1998), *La seconda lingua*, Milano, Italia, p. 8-9, <https://www.ictrecasali.scuolaer.it>.

⁴ A. Sula (2009), *Gabime të nxënësve dhe studentëve shqiptarë në përvetësimin e gjuhës italiane*. Monografi, f. 13, Tiranë.

Në bazë të këtij niveli gabimet mund të klasifikohen si vijon:

Gabime rastësore: mund të ndikojnë disa faktorë si: mjedisorë, emotivë, motivimi, fusha njohëse etj.

- Gabime fillestare, të cilat vijnë si pasojë e mosnjohjes së rregullave nga individ

- Gabime sistematike, të cilat përkojnë me fazën e njohjes së rregullave. Në këtë fazë vihen re korrigjime të shumta të bëra nga vetë individ. Ky është tregues i një procesi në zhvillim dhe nxjerr në pah dinamikën e “Ndërgjuhës”. Gabimet sistematike mund të grupohen sipas i) kategorisë gjuhësore (pjesët e ligjëratës), ii) nivelit të aftësisë (fillestarë, mesatar dhe i avancuar), iii) nivelit gjuhësor (morfologjike, sintaksore, ortografike, leksikore), iv) kriterit të përdorimit (gjuha e shkruar apo e folur).

- Gabime të panevojshme: të cilat vihen re gjatë përdorimit praktik të gjuhës dhe procesit të konsolidimit të gjuhës.

- Gabime të fosilizuara: të cilat vihen re në fund të një niveli (Rustipa K., 2011⁵).

Ndërgjuha nëpërmjet dialogjeve dhe rrëfimeve

Të gjithë jemi të vetëdijshëm për përhapjen dhe ndikimin që gjuha angleze ka marrë vitet e fundit. Duke pasur parasysh rëndësinë dhe impaktin që ka, mësimi dhe përvetësimi i kësaj gjuhe fillon që në moshë të vogël. Konkretisht në Shqipëri gjuha angleze studiohet pothuajse si gjuhë e parë në të gjitha nivelet shkollore, parauniversitare dhe universitare, madje në disa raste mësimi i gjuhës angleze fillon që në sistemin parashkollor. Lëvizja e shumtë e shqiptarëve, kryesisht në dhjetëvjeçarin e parë pas viteve '90 ka bërë të mundur që shumë prej fëmijëve të kenë jetuar ose lindur jashtë vendit. Pra këta individë janë përdorues shumë të mirë të të dy gjuhëve, të shqipes dhe asaj të vendit ku jetojnë apo kanë jetuar.

Për këtë arsye në momentin që nxënësit apo studentët shqiptarë vendosin të mësojnë një gjuhë të huaj të dytë gjatë procesit të përvetësimit ose më saktë në fazën e “Ndërgjuhës” ato do të kenë si gjuhë referuese jo vetëm gjuhën shqipe apo atë angleze por edhe gjuhën e huaj të parë me të cilën kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm.

Për rrjedhojë ndikimet dhe gabimet e vërejtura në fazën e ndërgjuhës do të lidhen me të dyja gjuhët, si me atë amtare ashtu edhe me gjuhën e parë të huaj të mësuar prej tij.

Në këtë punim janë marrë në shqyrtim rastet e nxënësve të cilët e mësojnë gjuhën italiane si gjuhë të dytë të huaj. Target grupi i studimit janë nxënës të klasave të 10 dhe të 12 të cilët e mësojnë këtë gjuhë si gjuhë të huaj të dytë. Si

⁵ K. Rustipa (2011), *Contrastive Analysis, Error Analysis, Interlanguage and the Implication to Language Teaching*. Ragam Jurnal Pengembangan Humaniora Vol. 11 No. 1, Stikubank University (Unisbank) Semarang, p.19. www.polines.ac.id.

aktivitet i propozuar për analizimin e gabimeve janë video të shkurtra të krijuara nga vetë nxënësit në të cilat është analizuar aftësia e të folurit në situata dialoguese dhe tregimtare (Muceku A., 2011⁶).

Analiza e rezultateve

Përsa i përket problemeve që paraqet secila prej tyre si në filmin e parë ashtu edhe në grupin e dytë të videove ato më evidentueset kanë qenë ato që lidhen me gjuhën, gramatikën, shqiptimin dhe përdorimin e gjuhës.

Në disa prej nxënësve vihen re edhe ndikime gjuhësore nga anglishtja, spanjishtja apo edhe fjali të menduara shqip dhe të përkthyer në italisht.

Në secilën prej këtyre videove kemi evidentuar problemet dhe gabimet që janë më të shpeshta dhe më të shumta në gramatikë, shqiptim dhe përdorimin e gjuhës. Ja disa prej gabimeve të bëra:

Grupi i parë

Ky grup përbëhet nga nxënës të klasave të 12-ta. Niveli gjuhësor: B1-B2. Ky grup përkon me fazën përfundimtare të Ndërgjuhës dhe për rrjedhojë performanca e tyre gjuhësore është e mirë

Episodi i katërt - “Al bar con le amiche”

Në aspektin gramatikor është vendosur në gjininë femërore struktura:

- *Questa fine settimana* - kur duhej të ishte përdorur në gjininë mashkullore, *questo fine settimana*.

- Në përdorimin e gjuhës një gabim që evidentohet është përdorimi i foljes *uscire* që në këtë rast është i panevojshëm.

- *Ai giovani piace uscire fuori* - kur duhej të ishte shprehur - *ai giovani piace uscire*.

- Në procesin e artikullimit të fjalëve është nyjetuar gabim vetëm fjala *anti`chi* duke e shqiptuar me theks tonik tek zanorja e parë a *a`ntichi*.

- Gjithashtu në pjesën e shkruar që paraprin episodin është përdorur fjala *gioventu`* për t’ju referuar të rinjve kur në fakt duhej të ishte përdorur *I giovani*.

- Episodi i pestë- “Guardando la TV”

- I vetmi gabim që është evidentuar në episodin e pestë është ai i përdorimit të gjuhës dhe pikërisht në fjalinë:

- *Seconda edizione* (di un film) kur duhej të ishte përdorur *stagione* në vënd të *edizione*, pra formulimi i saktë do të ishte *la seconda stagione* (di un film).

⁶ A. Muceku (2011), Projekt “Una giornata italiana”, Biblioteca Petro Nini Luarasi, 2009-2011, Tiranë, Shqipëri.

Grupi i dytë. Ky grup përbëhet nga nxënës të klasave të 10. Niveli i tyre gjuhësor është A1-A2. dhe për rrjedhojë performanca e tyre gjuhësore është e dobët.

Gjatë përdorimit të gjuhës gabimet që vihen re janë ato të përdorimit të shprehjeve të caktuara të cilat nuk qëndrojnë si të tilla nga pikëpamja e ndërtimit apo edhe të të shprehurit, p.sh.:

- *Per colazione mangio cereali con latte* kur duhej të thoshte *per colazione mangio latte e cereali*.

- *Dormire di nuovo* kur duhet të thoshte *dormire ancora*.

- *Sette classe* kur në vend të fjalës *classe* duhej të përdorte *ore*. Pra shprehja e saktë duhet të ishte *sette ore*.

- *Le ore sono sei* kur duhej të shprehej *sono le sei* për të treguar orën 6.

- *Ora per vestirmi*. Me këtë shprehje nxënësja ka dashur të thoshte tani duhet të vishem dhe ndërtimi i fjalisë duhej të ishte *ora devo vestirmi*.

- *Mi resto* është një strukturë foljore që ajo e ka huazuar nga anglishtja duke e përshtatur me strukturën e italishtes. Në këtë rast kemi të bëjmë me një ndikim gjuhësor i cili vihet re edhe tek nxënës të tjerë nga gjuhë të ndryshme. Pra ajo ka dashur të thotë *Mi rilasso* dhe ka përdorur shprehjen me të njëjtin kuptim në anglisht *Take rest*, duke i përshtatur vetëm formën në italisht.

Një ndikim tjetër gjuhësor vihet re edhe në shqiptimin e foljes *passare* e cila është shqiptuar *passamo* (nga spanjishtja) dhe jo *passiamo*. Problemet që vihen re me shqiptimin janë rastet që janë evidentuar më poshtë:

Është shqiptuar:

Lavore në vend të fjalës *lavoro*.

personi në vend të fjalës *persone*.

insieme në vend të fjalës *insieme*.

leggo është shqiptuar me *xh* dhe jo me *g*.

bevere në vend të fjalës *bere*.

Në aspektin gramatikor nxënësja ka shfaqur vështirësi në përdorimin e nyjeve, parafjalëve, përshtatjen e mbiemrit me emrin. p.sh. ajo ka thënë:

I lezioni në vend të *le lezioni*.

Poco compiti në vend të *pochi compiti*.

Molto compiti në vend të *molti compiti*.

Andiamo per bere në vend të *andiamo a bere*.

Përfundime dhe konkluzione.

- Nisur nga sa u tha më sipër si edhe nga vëzhgimet dhe analizimi i gabimeve të bëra gjatë aktivitetit të propozuar u vu re se “Ndërgjuha” është një proces kalimtar i cili në faza të ndryshme paraqet problematika dhe nivele të ndryshme gjuhësore. Kjo u vu re tek grupet e ndryshme të nxënësve të cilët megjithëse të vendosur para të njëjtit aktivitet (përdorimi i gjuhës së folur) manifestuan gabime dhe problematika të ndryshme.

Koncepti “ndërgjuha” dhe analizimi i gabimeve gjatë përvetësimit të gjuhës...

- Tek grupi me nivel gjuhësor A1-A2 përdorimi i gjesteve, shenjave apo gjuhës së trupit është më i shumtë dhe më frekuent sesa tek grupi i dytë.
 - Mekanizmi i quajtur “Transfer” mund të verifikohet jo vetëm nga gjuha nënë por edhe nga gjuhët e tjera të huaja të mësuara nga përdoruesi i gjuhës.
 - Mekanizmi “Transfer” është më i pranishëm në riprodhimin spontan sesa në atë të udhëhequr.
 - Mekanizmi “Transfer” ndodh në të disa kategori gramatikore, morfologji, sintakse, fonologji, ortografi, etj.
- Kjo metodologji e evidentimit, analizimit dhe vlerësimit të gabimeve është një feed-back dy palësh.

Nxënësit:

I ndërgjegjëson që ta kuptojnë “Ndërgjuhën” si një proces personal në përvetësimin e gjuhës së huaj.

I ndërgjegjëson që “gabimin” ta shikojnë si një moment kalimtar të procesit të përvetësimit të gjuhës së huaj.

Ju jep mundësi që t’i evidentojnë dhe t’i korrigjojnë “gabimet” e tyre dhe të shokëve duke realizuar në këtë mënyrë procesin e vetëvlerësimit.

Nxënësit bëhen bashkëvlerësues duke qenë më realist dhe objektiv në analizimin e performancës së tyre dhe në përcaktimin e nivelit njohës së gjuhës.

Mësuesit:

Evidentojnë problematika e përbashkëta të grupit.

Evidentojnë problematikat në kategori të caktuara gramatikore.

Bëjnë një vlerësim më objektiv dhe realist individual të nxënësit duke evidentuar problematikat personale të çdo nxënësi.

Evidentojnë më mirë llojet e gabimeve.

Shërbejnë për të reflektuar dhe përmirësuar punën dhe metodologjinë e mësuesit.

BIBLIOGRAFI

- A. Muceku (2011), Projekt “Una giornata italiana”, Biblioteca Petro Nini Luarasi, 2009-2011, Tiranë, Shqipëri.
- A. Sula (2009), *Gabime të nxënësve dhe studentëve shqiptarë në përvetësimin e gjuhës italiane*. Monografi, f. 13, Tiranë.
- G. Pallotti (1998), *La seconda lingua*, Milano, Italia, p. 8-9, <https://www.ictrecasali.scuolaer.it>.
- K. Rustipa (2011), *Contrastive Analysis, Error Analysis, Interlanguage and the Implication to Language Teaching*. Ragam Jurnal Pengembangan Humaniora Vol. 11 No. 1, Stikubank University (Unisbank) Semarang, p. 19. www.polines.ac.id.
- M. Liu, X. Sh. Liu (1998), Chomsky and Knowledge of Language, Proceedings of the Twentieth World Congress of Philosophy Boston, 10-15 August 1998, Massachusetts U.S.A. <https://www.bu.edu/wcp>.
- M. Mezzadri (2002), *La correzione degli errori* Articolo apparso su *In.it*, anno 3 N. 12, pp. 4-9. www.italianoperstranieri.it.

